REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT
T I R A N Ë

Nr.184 Akti **Nr.198 Vendimi**

VENDIM

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Apelit Tiranë, e perbere nga:

KRYESUES: EDMOND GOGO
ANETAR: GRAMOZ LEVANAJ
ANETAR: FATMIRA HAJDARI

Me asistencen e sekretares gjyqesore Gj.Bardhoshi, me date **25.11.2014,** mori ne shqyrtim, ne séance gjyqesore me dyer te hapura, çeshtjen civile, qe u perket paleve:

KERKUES: **S.C Energy Holding S.R.L.** Perfaqesuar me prokure nga Av.Gerhard Velaj.

Person i interesuar: **Koorporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH).** Perfaqesuar, me autorizim, nga **Artan Çela.**

Me pjesemarrjen e Avokatures se Shtetit. **Perfaqesuar nga Edlira Vasha.**

OBJEKTI: Njohja e vendimit perfundimtar te Gjykates Nderkombetare te Arbitrazhit, dt.18.02.2010, per çeshtjen civile me pale paditese S.C Energy Holding S.R.L, i paditur Koorporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH).

Baza Ligjore: Nenet 393, 395, 396, 397, 398 dhe 399 te Kodit te Proçedures Civile te Republikes se Shqiperise.

Gjykata e Apelit Tirane, pasi degjoi gjyqtarin Edmond Gogo, shqyrtoi çeshtjen, mori provat e nevojshme, degjoi perfaqesuesin e pales kerkuese S.C Energy Holding, qe kerkoi te njihet vendimi i huaj, degjoi perfaqesuesin e Koorporates Elektroenergjitike Shqiptare (KESH), Artan Çela, qe kerkoi rrezimin e kerkeses, avokaten e shtetit, qe kerkoi rrezimin e kerkeses:

VËREN

Kerkesa e kerkuesit duhet te pranohet dhe te njihet e t'i jepet fuqi zbatimi ne Republiken e Shqiperise te ketij vendimi.

Gjykata e Apelit, ne rigjykim, mbasi zbatoi detyrat e lëna nga Gjykata e Larte me Vendimin Nr.362, date 06.06.2014, konstatoi se:

Shoqeria S.C Energy Holding S.R.L dhe KESH, sh.a, rezulton te kene lidhur Kontratë Nr. Ref. 01-06/AJ-Ost, per blerjen dhe furnizimin me energji elektrike per periudhen 1Korrik 2006, deri ne 31 Dhjetor 2006. Sipas kesaj kontrate, bazuar ne kushtet dhe afatet e percaktuara, S.C Energy Holding S.R.L merrte persiper te furnizonte KESH me energji elektrike gjate periudhes 1 Korrik 2006, deri me 31 Dhjetor 2006. Ky furnizim do te kryhej ne dy pjese, Loti II dhe Loti III dhe secili prej loteve mbulonte furnizimin me energji elektrike gjate nje periudhe tre mujore. Per te garantuar furnizimin me energji elektrike, S.C Energy Holding S.R.L, sipas kushteve te percaktuara ne kontrate, e ka pajisur KESH me Garancine Bankare Nr.S8116258, te dates 27 Qersbor 2006, garanci e leshuar nga Alpha Bank, Romania SA Uniri Branch, e cila ishte ne masen 10% te v1eres se çdo Loti. Pas realizimit te furnizimit me energji elektrike, ne date 18 Janar 2007, KESH ka kerkuar terheqjen e garancise bankare te siperpermendur, duke pretenduar se S.C Energy Holding S.R.L nuk kishte permbushur detyrimet e saj per furnizimin me

energji elektrike sipas kushteve te kontrates.

Kerkuesi, lidhur me kete mosmarrveshje, i eshte drejtuar me kerkesëpadi Gjykates Nderkombetare te Arbitrazhit, ne Gjeneve te Zvicres, e cila ishte gjykata kompetente per zgjidhjen e mosmarrveshjeve qe rridhnin nga kjo kontratë.

Gjykata Nderkombetare e Arbitrazhit e ka konsideruar te pajustifikuar veprimin e KESH per terheqjen e garancise bankare dhe ka vendosur:

"Deklarimin e terheqjes nga KESH te Garancise Bankare Nr. S8116258, leshuar Alpha Bank, Romania SA Uniri Branch, ne date 27 Qershor 2006, te pajustifikuar dhe ne kundershtim te kushteve te percaktuara ne kontrate.

Detryimin e KESH t'i paguaje S.C Energy Holding S.R.L shumen 933,984.00 (nenteqind e tridhjete e tre mije e nenteqind e tetedhjete e kater) Euro, si dhe interesat ne masen 9%, te cilat do te perllogariten duke filluar nga data 19 Janar 2007 deri ne diten e shlyerjes se detyrimit, si dhe urdherimin e KESH te paguaje shumen e mesiperme dhe interesat mbas shpalljes se ketij vendimi.

Detyrimin e KESH t'i paguaje S.C Energy Holding S.R.L kostot dhe shpenzimet ligjore, perfshirë kostot e arbitrazhit, ne shumen 441,677.63 Euro, si dhe interesat ne masen 9%, te cilat do te perllogariten duke filluar nga momenti i njoftimit te ketij vendimi, deri ne diten e shlyerjes se detyrimit, si dhe urdherimin e KESH te paguaje shumen e mesiperme dhe interesat mbas shpalljes se ketij vendimi.

Rrezimin pa mundesi ankimimi te te gjitha ankesave, kerkesave dhe korigjimet e kerkuara nga i padituri (KESH).

Rrezimin pa mundesi ankimimi e te gjitha ankesave te tjera, te ngritura nga secila pale".

Gjykimi i kesaj gjykate rezulton te jete bere ne prezence te pales paditur KESH, sh.a. Vendimi i mesiperm i Gjykates se Arbitrazhit Nderkombetar eshte perfundimtar dhe i formes se prere.

Ne gjykim, perfaqesuesi i KESH dhe Avokatja e Shtetit pretenduan se vendimi nuk duhet te njihet, mbasi sipas tyre, nga ana e Gjykates se Arbitrazhit Nderkombetar nuk jane zbatuar dispozitat proçeduriale, duke i hequr mundesinë KESH te paraqiste prova ne gjykim dhe nuk ka pranuar te thirren deshmitarë.

Ky pretendim i KESH dhe Avokates se Shtetit nuk mund te merret parasysh, nderkohe qe Gjykata e Apelit, ne kete rast, nuk gjykon si gjykate e shkalles se dyte, por ka ne kopetence nje gjykim ekstra, njohje vendimi te huaj. Gjykata e Apelit ne kete rast zbaton kerkesat e Nenit 394 te K.Pr.Civile. Pra Gjykata e Apelit do te refuzonte njohjen e ketij vendimi, po qe se do te kishte nje nga ato pengesa qe parashikon kjo dispozite per mosnjohjen e vendimit te huaj. Ne rastin konkret, Gjykata e Apelit konstaton se palet jane marrë vesh dhe kane caktuar vetë gjykaten ku do te zgjidhin konfliktin dhe nga aktet del se eshte Gjykata e Arbitrazhit Nderkombetar Zvicer, ajo qe eshte zgjedhur nga palet. Vendimi nuk vjen ne kundershtim me ndonje dispozite ligjore te Republikes se Shqiperise. Pra gjykata nuk konstaton pengesa ligjore per mosnjohjen e ketij vendimi.

Ne rigjykim, Gjykata e Apelit mori dhe kontraten e perkthyer nga nje perkthyes i liçensuar nga Ministria e Drejtesisë. Pretendimi i Avokates se Shtetit se perkthimi eshte bere nga nje perkthyese e palinçensuar nga Ministria e Drejtesisë, eshte i pambeshtetur. Nga administrimi i perkthimit, del se perkthimi eshte bere nga Elton Xhembulla dhe jo, nga Flutura Xhabija, e cila ka perkthyr vetem vulen apostile.

I pasaktë eshte dhe pretendimi tjeter i Avokates se Shtetit se vendimi nuk eshte legalizuar nga Ministria e Jashtme, ose nga Ambasada jone ne Zvicer. Ne rastin konkret, vendimi eshte shoqeruar ne Vulë Apostile dhe si i tille, nuk ka nevoje te nenshkruhet nga keto organe.

Vendimi i Gjykates se Arbitrazhit Nderkombetar nuk vjen ndesh as me Nenin 5 te Konventes se New York-ut “ Per njohejn dhe ekzekutimin e vendimeve te arbitrazhit te huaj”, me te cilen vendi yne eshte bere palë.

Ne kushtet kur njohja e ketij vendimi nuk ka pengesa ligjore, ai duhet te

njihet dhe t’i jepet fuqi zbatimi ne Republiken e Shqiperise.

PËR KETO ARSYE

Gjykata e Apelit, pasi pa dhe Nenin 393 e vijues të Kodit të Procedurës Civile:

VENDOSI

Njohjen dhe dhenien fuqi zbatimi ne Republiken e Shqiperise te Vendimit date 18.02.2010 Gjykates Nderkombetare te Arbitrazhit te Gjeneves Zvicer, me palë Shoqerine SC.Energy Holding S.R.L, kunder K.E.SH, sh.a.

Kunder ketij vendimi mund te behet rekurs ne Gjykaten e Larte.

Tirane, 25.11.2014

A N E T A R	**A N E T A R**	**K R Y E S U E S**
Gramoz LEVANAJ	**Fatmira HAJDARI**	**Edmond GOGO**

dv. **dv.** **dv.**

Vertetohet njesia me origjinalin
Kancelari / Arber KUSHE